



**Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
Odeljenje za Zdravstvo i Socijalnu Zaštitu**

Nr i Protokolit 60
Me datën 08.04 .2024
Rahovec

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr. 08/L-197, neni 80 dhe 81 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, neni 62 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale të Komunave të Kosovës 03/L-040 dhe neni 81.1 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, shpall këtë;

K O N K U R S

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Rahovec:

Departamenti/Drejtoria: Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale-QKMF
Lloji i pozites: Zyrtar i të hyrave në QKMF (Profesional 2)
Numri i vendit te punës: Një (1)
Koeficienti: 4.95
Data e njoftimit: 08.04.2024
Afati për aplikim: 09.04.2024-08.05.2024

K U S H T E T –Zyrtar i të hyrave në QKMF (kualifikimi si më poshtë):

- Të kenë të kryer fakultetin ekonomik,
- Çertifikatë mjekësore,
- Vërtetimi nga gjykata që nuk është i/e dënuar dhe që nuk është nën hetime.
- Përvojë e punës 1 vjet,
- Rezumeja personale (CV),
- Letërnjoftimi i fotokopjuar.

Detyrat e punës –Zyrtar i/e i te hyrave:

- Të kryej punët lidhur me te hyrat ne QKMF,
- Përcjellja dhe regjistrimi i të dhënave nga te hyrat,
- Respektimi i afatit administrativ,
- Raportimi i rregullt (raportet periodike, raportet sipas nevojës dhe në rastet e veqanta kur kërkohet nga drejtori),
- Kryen edhe punë tjera sipas akteve normative.

Kushtet e përgjithshme dhe të vecanta për pranimin e zyrtarëve publik:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar,
- Të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët,
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore,
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale,
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik

Përgjegjësitë:

Sipas Ligjit të Punës dhe Ligjit për Shëndetësi si dhe Udhëzimeve Administrative dhe Rregulloreve në fuqi.

1. Mënyra e aplikimit;

Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet në kopje fizike së bashku me formularin e dorëzohen (kopje të vërtetuara) në zyrat e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në komunën e Rahovecit. Formulari i aplikimit merret në DSHPS, si dhe mund të shkarkohet nga linku: <https://konkursi.rks-gov.net>.

2. Mënyra e vlerësimit;

- **Jetëshkrimi i kandidatit (CV);**
- **Testimi me shkrim;**
- **Intervista me gojë.**

3. Kriteret e vlerësimit;

1. Procedura e vlerësimit të konkursit publik përmban gjithsej njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e konkursit publik.

2. Për pozitat të cilat nuk kërkohet testim me shkrim, jetë përshkrimi (CV) i kandidatit vlerësohet deri në tridhjetë (30) pikë, ndërsa intervista vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë.

3. Për pozitat të cilat kërkohet testimi me shkrim, jetë përshkrimi (CV) i kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë, testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë dhe intervistimi deri në njëzetë (20) pikë.

Kriteri i kalueshmërisë së testimit me shkrim është pesëdhjetë (50) pikë


4. Sqarime shtesë:

- Dokumentet duhet të jenë në kopje sepse ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistës;
- Informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi);
- Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet në Ligjin për Zyrtarët Publik.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e mangëta nuk pranohen.

Rahovec, 08.04.2024



Drejtoreshë e DSHPS-së


Saranda Sallteku